

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" JTD CONSULTING" SHPK

Sot ne daten 19.07.2023 , une i nenshkruari :

CRISTIAN JOVACCHINI , i biri i Luigi, i datelindjes 18.05.1994 , shtetas italian, lindur ne Lanciano (CH), me banim ne Itali ne adresen CONTRADA AQUILANO, N. 46 ORTONA(CH), i pajisur me karten e identitetit italiane nr.CA46077KL,

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Hartoj Statutin e Shoqerise "**JTD CONSULTING" SHPK** ,si me poshte :

NENI 1
EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet "**JTD CONSULTING" SHPK** dhe eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901 date 14.04.2008, si edhe Ligjit per QKR-se .

NENI 2
SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres,L.2, Rruga "A.Goga", ZK 8512, Nr.pasurie 22/593/ND-N8, Vol.68, faqe 152.


Shoqeria mund te krijojë filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

- Konsulence per ndermarrjet ne zhvillim, implementim dhe gjetjen e tregjeve te reja.
- Aktivite tregtare, financiare, të investimeve dhe pasurive të paluajtshme që janë të dobishme apo të lidhura me kryerjen e veprimtarive të mësipërme, duke përfshirë vendosjen e agjentëve, përfaqësuesve, kujdestarëve dhe komisionerëve.
- Import eksport, Tregti me shumice e pakice te artikujve te ndryshem.
- Agjenci udhëtimesh. Siguracione. Agjenci imobiliare.
- Dhenie me qira dhe shitblerje automjetesh.

NENI 4
KAPITALI I SHOQERISE

CRISTIAN JOVACCHINI


Kapitali i shoqërisë " JTD CONSULTING" SHPK është 30.000 Leke.

Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë dhe zotërohet në masën 100% nga ortakët i vetëm i saj, zoti **CRISTIAN JOVACCHINI**.

**NENI 5
MENYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TE KUOTAVE**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nepermjet:

- Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- Shitblerjes,
- Trashëgimise,
- Dhurimit,
- Cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

**NENI 6
Zmadhimi e zvogëlimi i kapitalit themeltar**

Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar të votave.

**NENI 7
KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të përcaktuar.

**NENI 8
ORGANET E SHOQERISE:**

Asambleja e përgjithshme.

Administratoret.

**NENI 9
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

CRISTIAN JOVACCHINI



Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- Percaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratorëve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspereve kontabel të autorizuar.
- Percaktimin e shpërblimeve për administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese.
- Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

NENI 10

Mbledhja e asamblese së përgjithshme .Menyra e thirrjes.

Mbledhja e asamblese mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e percaktuar sipas nenit 84 të ligjit.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori të paktën 1 herë në vit, për miratimin e llogarive të shoqërisë, por mbledhje të tjera mund të thirren gjatë vitit për çështje nga me të ndryshmet.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një shkrese dërguar çdo ortakut me postë të zakonshme ose mesazh elektronik. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen.

Ku asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikes së mesiperme, ajo mund të marrë vendime të vlefshme verem nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime , pavaresisht parregullsisë.

Kuorumi

- Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

CHRISTIAN JAVARCHINI


- Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Marrja e vendimeve

-Me perjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katertat e votave të ortakeve pjesmarres, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

-Me perjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për ceshtjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakeve pjesmarres.

-Me perjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmeria e vendimeve që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo me vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj, ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

-Te gjitha vendimet e asamblese duhet të regjistrohen në procesverbal.

NENI 11

E DREJTA E VOTES

Çdo kuotë i jep ortakut të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar të drejtën e një vote.

Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet, që kanë të bëjnë me kuotat, që ai disponon.

NENI 12

ADMINISTRATORET

Administratori i shoqërisë do të jetë zoti **ELVIN KURTI**, i datelindjes 17.04.1976, lindur në Durrës, me banim në Durrës, i pajisur me letërnjoftim nr.034887060 dhe nr.personal H60417192L, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje të këtij afati.

Administratori mund të shkarkohet në çdo moment nga asambleja, me shumicë të thjeshtë të votave, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të perjashtojnë apo kufizojnë këto të drejta.

NENI 13

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:

CRESTIAN JOVACCHINI

- Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme,
- Të përfaqësojë shoqërinë tregtare,
- Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë,
- Të bëjë të mundur përgatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe të nënshkruajë bilancin vjetor parashikues për vitin e ardhshëm, për tu miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, brenda dates 20 tetor të vitit paraardhës.
- Të bëjë të mundur përgatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe të nënshkruajë bilancin vjetor të mbyllur, për tu miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, brenda dates 20 mars të vitit të ardhshëm dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim,
- Të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë,
- Të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë,
- Të raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,
- Të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe statut.

NENI 14

Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë

Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë t'u shpërndajë ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë. Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqërinë.


NENI 15

Prishja e shoqërisë, largimi dhe perjashtimi i ortakeve.

Prishja e shoqërisë

Shoqëria priset :

- a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar në themelimin e saj,
- b)me vendim të asamblese së përgjithshme,
- c)me hapjen e procedurave të falimentimit,
- ç)nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723 date 3.5.2007 për "QKR",

CRISTIAN IOVACCINI


d) me vendim te gjykates,
dh) per arsye te tjera ,te parashikuara ne statut.

Largimi i ortakut

-Ortaku mund te largohet nga shoqeria :
-nese ortaket e tjere ose shoqeria kane kryer veprime ne dem te tij,
-nese eshte penguar te ushtroje te drejtat e tij,
-nese shoqeria i ka ngarkuar detyrime te paarsyeshme apo,
per shkaqe te tjera, qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise.

Perjashtimi i ortakut

Ne baze te nje vendimi te zakonshem, asambleja e pergjithshme mund ti kerkoje gjykates perjashtimin e ortakut, nese ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve te statutit , ose nese ekzistojne shkaqe te tjera te arsyeshme per kete perjashtim ,te parashikuara ne ligj.

NENI 16

Likuidimi i shoqerise

Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit.

Me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërisë ndërmjet ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

NENI 17

Ftesa për kreditorët

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

NENI 18

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë

CRISTIAN IVAČEVIĆ


Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

NENI 19

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut ,do te behet referim ne dispozitat e legjislacionit tregtar dhe atij shqiptar ne pergjithesi.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE " JTD CONSULTING" SHPK

CRISTIAN JOVACCHINI

CRISTIAN JOVACCHINI
